



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEKANATI**

Nr. Extra prot.

Elbasan, më 17.03.2020

**UDHËZIM**

**Nr.1, datë 17.03.2020**

**"PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË FAKUTETIN E SHKENCAVE HUMANE TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 43, të Statutit të Universitetit "A.Xhuvani", miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UE-së Nr.5 datë 30.01.2018, neni 19, si dhe në zbatim të Vendimit të Rektorit të UE-së, të datës 17.03.2020 "Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universiteti e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", pas diskutimeve dhe propozimeve online nga përgjegjësit e departamenteve, rreth metodave që do të përdoren për zhvillimin e procesit mësimor online në FSHH-së

**UDHËZON:**

1. Zhvillimin online të procesit mësimor në Fakultetin e Shkencave Humane, duke filluar më datë 17.03.2020 deri në daljen e një vendimi të dytë për fillimin e procesit mësimor në auditore.
2. Përdorimin e platformave online të komunikimit në grup për zhvillimin e procesit mësimor online si më poshtë:

- Google Clasroom
- Whatsapp group call
- Viber

- e-mail
- facebook
- videocall

3. Përzgjedhjen e një prej platformave online nga vetë pedagogët, duke marrë në konsideratë specifikat e lëndëve respektive, ku çdo pedagog:

- Krijon grupin e virtual të komunikimit me studentët e kursit sipas orarit përkatës. Grupi virtual i studimit krijohet me të gjithë apo më shumicën e studentëve të atij grupi studimi.

- Jep leksionet e lëndës, detyra, ushtrime, në programe të ndryshme kompjuterike për grupin e krijuar si dhe udhëzimet përkatëse.

- U përgjigjet pyetjeve të studentëve për çështje të ndryshme të lëndës.

- Ndjek ecurinë e përgatitjes së detyrave të kursit dhe të studentëve që punojnë për tezat e diplomës.

- Informon përgjegjësën e njësisë bazë për ecurinë e zhvillimit të mësimin online.

- Dokumenton zhvillimin e mësimin në evidencat përkatëse.

4. Ngarkohen përgjegjësit e departamenteve të FSHH-së për ndjekjen e zbatimit të këtij Udhëzimi.

5. Ngarkohet personeli ndihmës-akademik në mbështetje të zhvillimit online të procesit mësimor.

6. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**DEKANI**

**Prof.as.Dr.Albert RISKÀ**